

Hytbeja e xhumasë

2023/10/27 م

١٤٤٥/٤/١٢ هـ

Nga shejhu i nderuar Dr.

Abdul Muhsin bin Muhamed Al Kasim

Imam dhe hatib në xhaminë e Profetit
(sal-lallahu alejhi ue sel-lem)

Me titull

Tekbiri (Madhërimi i Allahut)



a-alqasim.com



Tekbiri (Madhërimi i Allahut)*

Lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, Atë e lavdërojmë, ndihmë e falje vetëm prej Tij kërkojmë, Atë të cilin Allahu e udhëzon nuk ka kush ta humb, e atë të cilin Ai e humb nuk ka kush ta udhëzojë, Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi صلى الله عليه وسلم është rob dhe i Dërguar i Tij.

*Hytbe e mbajtur në xhaminë e Profetit صلى الله عليه وسلم
në Medine më datë 12/4/1445 hixhri,
që përkon më 27/10/2023.

E më pas:

Kini frikë nga Allahu ashtu si i përket Atij dhe dijeni se jeni nën mbikqyrjen e Tij në çdo çast.

O ju muslimanë!

Esenca e të qënurit rob i Allahut qëndron në dashurinë absolute të shoqëruar me nënshtrimin absolut ndaj Tij. Ndaj, njohja e emrave dhe cilësive të Allahut është thelbi i njohurive si dhe dija më e vlefshme dhe nevoja më e madhe shpirtërore është njohja e Krijuesit, e këto nuk arrihen veçse duke njohur emrat e cilësitë e Tij.

Në varësi të njohjes së emrave e cilësive të Allahut qëndron nënshtrimi i njeriut ndaj Allahut, dashuria dhe bindja ndaj Tij, dhe sa më shumë të informohet njeriu rreth emrave e cilësive të Allahut aq më shumë shtohet besimi dhe forcohet bindja e tij. Allahu i Lartësuar e vendos njeriun në pozitën që njeriu vendos Allahun në zemrën e tij.

Emrat e Allahut të Lartësuar janë lëvdata absolute, Allahu i ka cilësuar si të mira absolute, ngase ato tregojnë për cilësitë e Tij hyjnore, e prej emrave të Allahut është “el Kebir”, i Madhi; e Allahu është i Madh në emrat e cilësitë e Tij, e prej cilësive të Tij janë madhështia e lartësia.

Ai i cili është i bindur se Allahu është i Lartë sipër krijesave të Tij, e më i madh se çdo gjë; e madhëron Atë ashtu si i përket e nuk adhuron askënd tjetër veç Tij.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْحَقُّ وَأَنَّ مَا يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ الْبَطْلُ وَأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْعَلِيُّ الْكَبِيرُ﴾

“Kjo është kështu, sepse Allahu është i Vërteti, ndërsa çfarë adhurohet në vend të Tij është e rreme dhe se Allahu është i Lartësuar dhe i Madhërishëm”.
[Lukman: 31]

Krijesat që ekzistojnë – të dukshmet e të padukshmet -, asnjë nuk e di numrin e tyre, e nuk është i informuar detajisht rreth tyre askush veç Allahut, i cili thotë:

﴿عَلِمُ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ الْكَبِيرِ الْمُتَعَالِ﴾

“Ai i di gjërat e dukshme dhe të padukshme. Ai është i Madhi, i Larti”. [er Ra’d: 9]

Prej cilësive të Allahut të Lartësuar është që ai flet, e fjalët e Tij janë madhështore.

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم thotë: **“Kur Allahu në qiell flet për ndonjë çështje, melaiket (engjëjt) përplasnin krahët e tyre, të nënshtruar ndaj fjalës së Tij, e cila ngjan me përplasjen e hekurit mbi gurin e lëmuar, e pasi largohet nga zemrat e tyre frika, melaiket pyesin njëri tjetrin: “Çfarë ka thënë Zoti juaj?”**

Melaiket e tjerë përgjigjen: “Tha të drejtën, Ai është i Lartësuari, i Madhi”. [tr. Buhariu]

Allahut i takon kryelartësi dhe sundimi i plotë, Ai gjykon mes krijesave me drejtësi:

﴿فَالْحُكْمُ لِلَّهِ الْعَلِيِّ الْكَبِيرِ﴾

“Gjykimi i përket vetëm Allahut, të Lartit e të Madhërishmit”. [Gafir: 12]

Ai i ka urdhëruar njerëzit që ta madhërojnë, e ta lartësojnë larg çdo të mete që dikush mund t’ia atriboj Atij.

﴿قُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي لَمْ يَتَّخِذْ وَلَدًا وَلَمْ يَكُنْ لَهُ شَرِيكٌ فِي الْمَلِكِ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ وَاوِيٌّ مِنَ الذُّلِّ
وَكَبِيرُهُ تَكْبِيرًا﴾

“Thuaj: Çdo lavdërim i përket Allahut, i Cili nuk ka bir, nuk ka ortak në pushtet dhe nuk është i pafuqishëm, që të ketë nevojë për ndihmës, dhe madhëroje Atë duke e lartësuar!”. [el Isra: 111].

Qëllimi nga adhurimet që banorët e qiejve e të tokës i bëjnë Allahut është lartësimi dhe madhërimi i Tij, ndaj tekbiri (fjala: “Allahu Ekber”) është devizë (moto) në adhurimet e mëdha. Tekbiri në namaz tregon për nënshtrim dhe përulje para madhësisë së Allahut dhe lartësisë së Tij, ndaj tekbirat e namazit gjatë një dite – prej ezanit e deri te përfundimi i dhikrit pas pesë namazeve farze dhe suneteve – arrijnë në treqind e shtatdhjetë e pesë tekбира.

Shejhul Islami Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë) thotë: “Fjala (Allahu Ekber) tregon për madhësinë e Allahut, pasiqë lartësia (el Kibrija’) përfshinë madhësinë (el Adhamah), dhe është më e gjerë në kuptim”.

Gjithashtu, haxhi është prej simboleve të dukshme fetare, motoja e të cilit është njësimi i Allahut, madhërimi i Tij duke thënë “Allahu Ekber” gjatë ecjes mes Safa dhe Merua, si dhe gjatë hedhjes së guralecëve.

Ditët më të vlefshme të Allahut janë dhjetë ditët e para të muajit Dhul Hixhe, e prej veprave më të mira gjatë tyre është tekbiri (fjala “Allahu Ekber”).

Profeti صلى الله عليه وسلم ka thënë: **“Nuk ka ditë më të mira, e as ditë në të cilat veprat janë më të dashura të Allahut se këto dhjetë ditë, ndaj shpreshtoni në to, tekbirin (Allahu Ekber),**

tehlilin (La ilahe il-lall- llah), **dhe tahmidin** (elhamdulillah)”. [Tr. Ahmedi].

Është e pëlqyeshme që tekbiri të thuhet në festat e bajramit, gjatë gëzimeve dhe kur njeriut i vjen ndonjë lajm i mirë.

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم ka thënë: **“Shpresoj që të jeni gjysma e banorëve të Xhennetit”**, transmetuesi i hadithit, Ebu Seid el Hudriu tregon se kur dëgjuan këtë hadith thanë: **“Allahu Ekber”**. [Tr. Buhariu].

Tekbiri gjithashtu thuhet kur njeriu sheh diçka nga shenjat e fuqisë së Allahut si eklipsi, apo kur çuditet nga diçka madhore.

Kur disa njerëz i kërkuan Profetit صلى الله عليه وسلم që t’u caktonte atyre një pemë që të merrnin te ajo mirësi, ai tha: **“Allahu Ekber! Kështu i thanë beni Israilët Musait: Na bëj neve një zot ta adhurojmë, sikurse edhe të tjerët kanë zota që i adhurojnë”**. [Tr. Nesaiu]

Gjatë udhëtimit, njeriun mund ta shoqërojë shqetësimi, mërzitja apo frika, ndaj, madhërimi i Allahut duke thënë **“Allahu Ekber”** është prehje e qetësim për të.

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم kur qëndronte mbi deve për të udhëtuar thoshte: **“Allahu Ekber”** tre herë. [Tr. Muslimi].

Gjithashtu, tekbiri thuhet kur njeriu sheh diçka prej krijsave madhështorë, si psh: vendet e larta, apo kur ngjitet në ndonjë vend të lartë.

Xhabir bin Abdullah thotë: **“Kur ngjiteshim lart (gjatë udhëtimit) thoshim: Allahu Ekber”**. [Tr. Buhariu].

Muslimani e mbyll ditën e tij me tekbir, kur ai shtrihet për të fjetur thotë tridhjetë e tre herë “Subhanallah” dhe “Elhamdulillah”, dhe tridhjetë e katër herë: “Allahu Ekber”.

Tekbiri thuhet në rrethanat me rëndësi të madhe, e prej mirësive të mëdha që Allahun meriton të falenderohet për të është udhëzimi, e prej falenderimit ndaj kësaj mirësie është madhërimi i Allahut që na ka udhëzuar në ndjekjen e fesë së Tij, e çdo gjëje që Ai e do.

﴿لَنْ يَنَالَ اللَّهَ لُحُومُهَا وَلَا دِمَاؤُهَا وَلَكِنْ يَنَالُهُ التَّقْوَىٰ مِنكُمْ
كَذَلِكَ سَخَّرَهَا لَكُمْ لِتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَىٰ مَا هَدَاكُمْ﴾

“Te Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tua, që ju ta madhëroni Allahun sepse ju ka udhëzuar”. [el Haxh: 37].

Prej falenderimit ndaj kësaj mirësie është madhërimi i Allahut (tekberi) për qëndrueshmërinë në udhëzimin e Tij duke kryer ibadetet e kërkuara.

Allahu i Lartësuar thotë:


﴿وَلِتُكْمِلُوا الْعِدَّةَ وَلِتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَىٰ مَا هَدَاكُمْ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ﴾

“Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë”. [el Bekare: 185]

Shejhul Islami thotë: “Tekbiri thuhet për udhëzimin, furnizimin dhe fitoren. Këto tre gjëra janë ato që më së shumti njeriu i kërkon, në to përfshihen gjithë interesat e tij”.

“Allahu Ekber” është fjalë e madhe që Allahu ka urdhëruar të thuhet; në mënyrë që në zemrën e njeriut të mbizotëroj madhështia e Allahut.

Allahu i lartësuar thotë:



“Zotin tënd madhëroje”. [el Muddeththir: 3]

Kurtubiu thotë: “Fjala arabe më e shkurtër e më domethënëse rreth madhësisë e madhërimit është fjala: Allahu Ekber”.

Ajo është fjala e natyrshmërisë (pastërtisë) në të cilën Allahu i ka krijuar mjerëzit:

Enes bin Malik tregon se i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم dëgjoi një person që tha: Allahu Ekber, Allahu Ekber, dhe tha: **“Është në natyrshmërinë e tij”**. [Tr. Muslimi]

Shpërblimi i kësaj fjale është i madh, me të arrihen gradët e larta dhe ajo është prej fjalëve që Allahu i do.

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم thotë: **“Fjalët më të dashura te Allahu janë katër: Subhanallah, Elhamdulillah, La ilahe il-lAllah, dhe Allahu Ekber”**. [Tr. Muslimi].

Tekbiri është sadaka (lëmoshë) që njeriu ia jep vetes, dhe mirësi.

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم thotë: **“Çdo tekbir është sadaka”**. [Tr. Muslimi].

Gjithashtu, melaiket rrethojne me krahët e tyre deri në qiellin e kësaj bote vendet e dhikrit, në të cilat bëhet tesbih (Subhanallah) dhe tekbir (Allahu Ekber). [Tr. Buhariu dhe Muslimi].

Me tekbir (Allahu Ekber), tahmid (Elhamdulillah) dhe tesbih (Subhanallah) hapen dyert e qiellit.

Ibn Umeri thotë: “Ishim duke u falur me të Dërguarin e Allahut ﷺ, e një person tha:

Allahu Ekber kebiran, uelhamdulillah kethiran, ue subhanallahi bukraten ue esilan.

E madhëroj Allahun duke thënë “Allahu Ekber”, e falenderojë Atë shumë, dhe e lartësojë Atë duke thënë “Subhanallah” në mëngjes e në mbrëmje.

I Dërguari i Allahut ﷺ tha: **“Kush i tha këto fjalë?”**.

“Unë, o i Dërguar i Allahut” – tha ai.

I Dërguari i Allahu ﷺ tha: **“Jam çuditur prej tyre, u hapën për to dyert e qiellit”**. [Tr. Ahmedi].

Tekbiri, do të jetë i rëndë në peshoret e ditës së gjykimit:

Profeti ﷺ thotë: **“Sa të vlefshme dhe sa të rënda në peshore janë pesë gjëra: La ilahe il-lAllah, Allahu Ekber, Subhanallah, Elhamdulillah, dhe fëmija i mirë i cili vdes dhe prindërit e tij llogarisin shpërblimin te Allahu”**. [Tr. Ahmedi].

Më pas: O ju muslimaë!

Allahu është i madh, e askush nuk është më i madh se Ai, atij i përket gjithë madhështia në qiej e në tokë.

Është e pamundur për njeriun llogjikisht të përftytyroj madhështinë e Tij, apo ta kuptoj Atë sikurse është realisht.

Çdo përftytyrim që mund ti vijë në mendje njeriut në lidhje me madhështinë e Allahut; Allahu është akoma më i madh.

“Allahu (ditën e gjykimit) do të vendos qiejt me një gisht, tokat në një gisht, pemët në një gisht, ujin dhe dheun e lagur në një gisht, dhe krijesat e tjera në një gisht”. [Tr. Buhariu dhe Muslimi].

Ndaj, besimtari mbrohet me Zotin e madh, Atij i mbështetet, te Ai i kanon çështjet, vetëm Atij i lutet, e vetëm me Të e lidh zemrën

Kërkoj mbrojtje prej Allahut nga Shejtani i mallkuar:

﴿وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ وَالْأَرْضُ جَمِيعًا بِيَمِينِهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَالسَّمَاوَاتُ

مَطْوِيَّاتٍ بِيَمِينِهِ سُبْحَانَهُ وَتَعَالَى عَمَّا يُشْرِكُونَ﴾

“Ata nuk e kanë vlerësuar siç duhet fuqinë e Allahut. Në Ditën e Kiametit, e tërë Toka do të jetë në grushtin e Tij, ndërsa qiejt do të mbështillen nën të djathtën e Tij. Qoftë i lavdëruar Ai dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!”. [ez Zumer: 67]



Hytbeja e dytë

E lavdërojmë Allahun për mirësitë që na ka dhënë, dhe e falenderojmë Atë që na ka drejtuar dhe dhuruar shumë.

Dëshmoj duke e madhëruar Allahun se nuk ka Zot që meriton të adhurohet veç Tij, dhe se Profeti jonë Muhamedi صلى الله عليه وسلم është rob dhe i Dërguar i Tij.

O ju muslimanë:

Nuk ka kënaqësi, mirësi, e as qetësi për njerëzit veçse duke njohur Zotin e tyre, e duke qenë qëllimi i tyre kryesor vetëm Allahu, dhe njohja e Tij gëzimi i tyre më i madh.

Prej veçorive të Allahut është lartësia, dhe Ai ka kërcënuar këdo që cilësohet me të prej njerëzve.

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم thotë: **“Madhështia është izari i Tij, dhe lartësia është rida’i⁽¹⁾ i Tij, e kush cilësohet me to, do ta ndëshkojë”**. [Tr. Muslimi].

) ¹ (“Izari” është rroba e cila vishet në pjesën e poshtme të trupit, ndërsa “Rida’i” është rroba që vishet në pjesën e sipërme të trupit.

Hadithi tregon që prej cilësive të Allahut të Lartësuar janë madhështia (el Adhama) dhe lartësia (el Kibrija), ndërsa përmendja e Izarit dhe Rida’it nuk do të thotë që ato janë prej cilësive të Allahut, sikurse kur thuhet për njerin që është veshur kokë e këmbë me mëndjemadhësi, nuk do të thotë që mëndjemadhësia është rroba e tij në realitet, por qëllimi është që personi është mëndjemadh dhe mëndjemadhësia është prej cilësive të tij (shënim nga përkthyesi).

Ibn Kajjimi thotë: “Duke qenë se lartësia është më gjithëpërfshirëse, përshtatet për të më së shumti emri i mbulesës (rida’).”

Ndaj, le të ketë kujdes njeriu nga mëndjemadhësia e arroganca ndaj të tjerëve. Kujt i është dhënë fuqi e prestigj dhe i vjen në mendje t’i bëj padrejtësi dikujt që është më i dobët se ai – si psh: gruas së tij apo dikujt tjetër - le të kujtoj që Allahu më i madh se ai në veten e Tij, pozitë, dhe sundim.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿فَإِنْ أَطَعَكُمْ فَلَا تَبْغُوا عَلَيْهِمْ سَبِيلًا إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا كَبِيرًا﴾

“Nëse ato ju binden, atëherë mos i ndëshkoni më. Allahu, me të vërtetë, është i Lartësuar dhe i Madhëruar!”. [en Nisa: 34].

Personi që është i bindur që Allahu është i madh i shtohet frika e tij ndaj Allahut, e madhëron Atë, e do dhe i kryen adhurimet në mënyrë të përsosur, dhe del nga zemra e tij mëndjemadhësia, vetëpëlqimi e syfaqësia.

Allahu i ka premtuar Xhennetin njerëzve modestë, sikurse ka thënë:

﴿تِلْكَ الدَّارُ الْآخِرَةُ نَجَعَهَا لِلَّذِينَ لَا يُرِيدُونَ عُلُوًّا فِي الْأَرْضِ وَلَا فِسَادًا
وَالْعَقِبَةُ لِلْمُتَّقِينَ﴾

“Sa për shtëpinë e botës tjetër, Ne do ta caktojmë atë për ata që nuk kërkojnë as madhësi e as ngatërresa në



Tokë. Përfundimi (i mirë) është për ata që ruhen nga të këqijat". [el Kasas: 83]

E pas kësaj: Djeni që Allahu ju ka urdhëruar të çoni salavate dhe selam mbi Profetin Muhamed صلى الله عليه وسلم ...

خطبة الجمعة

2023/10/27 م

١٤٤٥/٤/١٢ هـ

لفضيلة الشيخ الدكتور :

د. عبد المحسن بن محمد الفهمي
إمام وخطيب المسجد النبوي الشريف

بعنوان

التكبير

مترجمة باللغة الألبانية



a-alqasim.com